



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL  
AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME  
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ARKIV-PROTOKOLLIT

Nr. 4992 Prot.,

Tiranë, më 26 Q. 2024

**SHPALLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE  
NË  
DRAKU KORÇË**

Në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në RSH”, i ndryshuar, neni 19, pika 1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në RSH”, ligjit nr.9863, datë 28.1.2008 “Për Ushqimin”, i ndryshuar, ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, i ndryshuar, ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në VKM-në nr. 708, datë 9.9.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 128, datë 26.10.2020 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit”, Rregullores së Brendshme për organizimin dhe Funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, të miratuar me Urdhrin nr. 297, datë 23.6.2022 të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Manuali I Rekrutimit (i ndryshuar),

1. **Autoriteti Kombëtar i Ushqimit** shpall **1 (një)** pozicion të lirë pune në **Drejtorinë Rajonale të AKU-së, Qarku Korçë** si vijon:

- 1 (një) pozicione të lirë pune **“Inspektor” (Veteriner)** në Sektorin e Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OBU.

**A) Kriteret e veçanta për vendin e shpallur vakant:**

Për pozicionin **“Inspektor” (Veteriner)** në Sektorin e Kontrollit të Ushqimit, Ushqimit për Kafshë dhe OBU, kategoria IV-2.

- **Arsimi:**

Të zotërojë diplomë të nivelit minimal "Bachelor" ose diplomë të nivelit "Master Profesional" ose diplomë të nivelit "Master i Shkencave" ose "Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike" ose të barazvlefshme me to, në fushat e kërkuara:

- Mjekësi Veterinare

*(Edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë).*

*\*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.*

- **Përvoja:**

- Të ketë të paktën 1 vit eksperiencë pune;
- Të ketë njohuri shumë të mira të specialitetit brenda fushës profesionale, sipas veprimtarisë që mbulon;
- Të ketë njohuri të mira të procedurave administrative; aftësi për të përcaktuar objektivat, vendosur prioritete dhe respektuar afatet; aftësi për të shqyrtuar, verifikuar dhe vlerësuar;
- Të ketë njohuri të përdorimit të programeve bazë kompjuterike;
- Preferohet të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze/të huaja.

## **B) Kriteret e veçanta për vendet e shpallura vakante**

Personat e interesuar duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- Të ketë integritet të lartë profesional e moral;
- Të mos jetë i/e dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- Të mos jetë përjashtuar/shkarkuar nga administrata publike;
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe prezantimi.

## **C) Rregullat mbi mënyrën, afatin e dorëzimit të aplikimeve dhe kualifikimin e kandidatëve:**

1. Personat e interesuar duhet të dorëzojnë CV dhe dokumentacionin përkatës si vijon:
  - Kërkesë për punësim;
  - Jetëshkrim;
  - Fotokopje të diplomës të noterizuar me origjinalin;
  - Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
  - Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
  - Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
  - Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;

- Vetëdeklarim të mos jetë përjashtuar/shkarkuar nga administrata publike.

***Shënim: Mosdorëzimi i dokumenteve të mësipërme dhe mosplotësimi i kriterëve, e s'kualifikojnë automatikisht aplikantin.***

2. Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet brenda 3 ditëve pune nga data e shpalljes në faqen zyrtare [www.aku.gov.al](http://www.aku.gov.al), nëpërmjet adresës së email [bnjz.aku@aku.gov.al](mailto:bnjz.aku@aku.gov.al).
3. Aplikimet pranohen nga data 26.9.2024 deri në datë 30.9.2024 përfshirë të dyja këto data.
4. Brenda 1 dite pune struktura përgjegjëse për burimet njerëzore pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, mban procesverbal evidentues mbi mangësitë ose jo në dokumentacion dhe kryen shpalljen në faqen zyrtare [www.aku.gov.al](http://www.aku.gov.al) të njoftimit për kandidatët e përzgjedhur.
5. Çdo kandidat ka të drejtën për ankim jo më vonë se 24 orë nga shpallja e njoftimit.
6. Njoftimi dhe komunikimi me kandidatët, do të bëhet nëpërmjet numrit të telefonit ose adresës së postës elektronike të deklaruar.
7. Struktura e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të rekrutimit dhe hartimin dhe arkivimin e dokumentacionit përkatës.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**EDMOND BRUSHI**

